

Intervistë me ministrin e Financave, Avdullah Hoti

SEKTORËT E IDENTIFIKUAR PËR INVESTIME KAPITALE

*Planifikohet të ketë një bashkëpunim më të theksuar me partnerët ndërkombëtarë dhe institucionet financiare ndërkombëtare për të siguruar mbështetje për iniciativa të reja investuese, që konsiderohen të jenë strategjike dhe me ndikim të lartë në përmirësimin e konkurrueshmërisë dhe zhvillimin socioekonomik, thotë ministri i Financave, Avdullah Hoti, në intervistën për revistën *Ekonomia**

Mehmet GJATA

Në një intervistë për revistën *Ekonomia*, ministri i Financave, Avdullah Hoti, thotë se tashmë i kanë identifikuar sektorët në të cilët do të orientohen investimet kapitale dhe se janë të vendosur në realizimin e tyre. Hoti thotë se kanë marrë për bazë shkallën e lartë të papunësisë dhe faktin se shumica e popullsisë shpenzon rreth 45% të të ardhurave të tyre në produkte ushqimore dhe të kenë vlerësuar se reduktimi i normës së TVSH-së në produkte bazë do të rrisë mirëqenien në vend, e në veçanti atë të qytetarëve me të ardhura më të ulëta.

Ndër hapat më sijnifikantë që reflektohet në ligjin e TVSH-së dhe në reformën fiskale, përpos përshkallëzimit të TVSH-së, sipas Hotit, është lirimi nga TVSH-ja i linjave të prodhimit dhe makineritë që ndërlidhen me atë prodhim. Ndërsa, siç thotë ai në këtë intervistë, faza e dytë e stimujve për prodhuesit vendorë konsiston me lirime nga obligimet doganore për aktivitetet prodhuese e cila do të jetë në funksion të nxitjes së prodhimit vendor dhe si rrjedhojë në zëvendësim të importit. Ai thotë se kjo masë pritet të përmirësojë likuiditetin e bizneseve prodhuese vendore dhe është e një rëndësie të veçantë duke marrë parasysh vështirësitë dhe koston e lartë për ndërmarrjet në qasje në financa.

Prioritetet qeveritare për reforma strukturore dhe zhvillimore

Ekonomia: Zoti Ministër, a mund të na i jepni pikat kryesore ku do të fokusohet programi i Qeverisë së Kosovës për sa i përket zhvillimit ekonomik dhe si do të realizohen ato?

Hoti: Me Programin e Qeverisë jemi fokusuar dhe të vendosur që resurset administrative dhe financiare t'i drejtojmë në zhvillimin ekonomik të vendit. Kemi prezantuar rrugën tonë drejt ndërtimit të bazës për rritje të qëndrueshme ekonomike si dhe jemi të vendosur që këtë qëllim ta arrijmë përmes dy drejtimeve; pra përmes reformave strukturore dhe përkrahjes së vazhdueshme fiskale/financiare dhe administrative ndaj sektorëve të prodhimit që konsiderojmë se kemi përparësi krahasuese, përmes reformave strukturore, me theks të veçantë në arsim, po ashtu ne synojmë të krijojmë një bazë të shëndoshë në mënyrë që rritja ekonomike të jetë e qëndrueshme dhe sa më pak të jetë e varur nga shpenzimet publike.

Gjithashtu, përmes këtyre reformave ne jemi duke punuar që ta ngremë produktivitetin e sektorit tonë privat, në mënyrë që të jetë sa më konkurrues në tregun vendor dhe në tregtinë me jashtë. Kur flasim për reformat strukturore, në këtë kontekst jemi duke punuar ngushtë edhe me sektorin privat, në mënyrë që brengat e tyre të kamotshme t'i

përcaktojmë për zgjidhje. Nga bashkëpunimi me këtë sektor, ku edhe kemi nxjerrë tri ligjet të cilat e rregullojnë sistemin tatimor në vend, kemi ofruar incentiva dhe skema mbështetëse për ngritjen e aktivitetit prodhues në vend, këtu kemi parasysh mbështetjet fiskale dhe skemat e ndryshme mbështetëse për sektorin e prodhimit.

Ekonomia: Pas miratimit nga Qeveria të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2016-2018, keni deklaruar se kufijtë buxhetorë dhe kufijtë e të hyrave që ajo vendos, plotësisht i akomodojnë objektivat që i ka kjo Qeveri për 3 vjetët e ardhshëm. Si do të akomodohen këto objektiva?

Hoti: Po e theksoj prapë se ne me Programin Qeverisë kemi deklaruar prioritetet tona për reforma strukturore dhe zhvillimore për periudhën afatmesme. Këto prioritete janë në pajtueshmëri të plotë me partnerët qeverisës dhe rrjedhimisht ato përfaqësojnë prioritetet për ministritë e linjës.

Si rrjedhojë, gjatë përpilimit të KASH-it dhe vendosjes së kufijve buxhetorë, ne kemi pasur konsulta të vazhdueshme me të gjitha organizatat buxhetore nga të cilat është kërkuar që përbrenda prioriteteve që dalin nga programi qeverisës të përcaktojnë nevojat e tyre të financimit për periudhën afatmesme. Njëkohësisht është kërkuar nga organizatat buxhetore që gjatë përcaktimit të nevojave të financimit për periudhën planifikuese të kenë në konsideratë kufizimet buxhetore. Dhe vlen të përmendet se nga ky bashkëpunim ne kemi arritur që në masë të konsiderueshme të akomodojmë objektivat strategjike dhe jemi të përkushtuar që t'i përmbushim në mënyrë të plotë brenda mandatit qeverisës.

Ekonomia: Po rritjen ekonomike në vend në 3 vjetët e ardhshëm prej 4,4 për qind dhe rritjen e të hyrave të përgjithshme mesatarisht 20 për qind, si do t'i arrini?

Hoti: Ne kemi prezantuar në KASH, një planifikim mjaft konservator në pjesën ku flitet për zhvillimin e indikatorëve makroekonomik të cilët janë determinues në planifikimet mbi të hyrat e rregullta buxhetore. Pra, sipas analizave të Ministrisë së Financave, ku janë marrë për bazë politikat e ndërmarra, me theks të veçantë në pakon fiskale dhe përmirësimin gradual të ambientit të jashtëm ekonomik, ku kemi parasysh zhvillimet ekonomike pozitive në Unionin Evropian, parashikohet një rritje mesatare prej rreth 4.4% për periudhën planifikuese. Të shtyrë nga kjo rritje ekonomike dhe si rezultat masave të ndërmarra drejt ngritjes së efikasitetit të agjencive mbledhëse si dhe iniciativat e ndryshme për uljen e ekonomisë joformale dhe shumë hapa të tjerë, presim që në fund të vitit 2018 të hyrat të jenë më të larta për rreth 20% në raport me të hyrat e vitit 2014.

Për këtë arsye ne kemi qenë të kujdesshëm në planifikimin financiar në mënyrë që të sigurojmë një bazë të qëndrueshme të financimit, ku në këtë KASH, në planifikimin e të hyrave të rregullta buxhetore, nuk kemi marrë për bazë një mori të projekteve madhore me ndikim të lartë socio-ekonomik, me qëllim që të shohim dinamikën e realizimit të tyre dhe pastaj efektet e tyre t'i inkuadrojmë në planifikimet e ardhshme fiskale dhe ekonomike. Nëse brenda periudhës planifikuese ne arrijmë që t'i përmbyllim me sukses këto projekte, atëherë presim që të hyrat e rregullta buxhetore ta tejkalojnë shumën e planifikuar me këtë KASH.

Buxhetohet financimi i autostradës Prishtinë – Han i Elezit

Ekonomia: Në këtë kontekst, zoti Ministër, a do të ketë buxhet të mjaftueshëm për të përmbyllur investimet e nisura kapitale (autostrada Prishtinë-Han i Elezit) apo për të nisur ndonjë projekt të rëndësishëm kapital për vendin?

Hoti: Brenda kufizimeve buxhetore dhe planifikimit për shpenzimet kapitale, ne kemi krijuar hapësira të nevojshme për projekte të reja kapitale dhe gjithashtu kemi buxhetuar financimin e autostradës Prishtinë – Han i Elezit. Ashtu siç është prezantuar në KASH, ne planifikojmë të kemi një bashkëpunim më të theksuar me partnerët tanë ndërkombëtarë dhe institucionet financiare ndërkombëtare, në mënyrë që të sigurojmë mbështetje për iniciativa të reja investuese që ne konsiderojmë ato të jenë strategjike dhe me ndikim të lartë në përmirësimin e konkurrueshmërisë dhe zhvillimin socio-ekonomik. Pra, ne tanimë i kemi identifikuar sektorët në të cilët do të orientojmë investimet kapitale dhe jemi të vendosur në realizimin e tyre, ku këto investime të jenë në funksion të përshejtimit të dinamikës së zhvillimit të sektorit privat, si promotor i zhvillimit të gjithmbarshëm ekonomik të vendit.

Janë eliminuar barrierat e fiskalizimit

Ekonomia: Kur do të fillojë të zbatohet vendimi i Qeverisë për faljen e borxheve të viteve 1990-2008, ose a po vonohet ky vendim jo pak i kritikuar, por edhe shumë i arsyetuar nga Qeveria?

Hoti: Siç jeni në dijeni, Qeveria tashmë e ka aprovuar rekomandimin e Komisionit për faljen e borxheve, ku parashihet që ky proces të rregullohet me Ligj të veçantë dhe në momentin që ne po flasim ky Ligj ka marrë formën e tij dhe pritet që për pak ditë të miratohet nga Qeveria.

Ndërkaq, për sa u përket disa reagimeve sporadike karshi këtij vendimi, mund të them se për cilindo vendim qeveritar apo vendime të tjera po paraqiten kritika. Megjithatë, vlerësojmë se kritikën para së gjithash duhet të jenë me bazë dhe të argumentuara mirë.

Ekonomia: Si do të funksiononin ATK-ja dhe Doganat, nëse do jetësohej Ideja juaj për bashkimin e tyre?

Hoti: Po për të mos shkaktuar çrregullime në sistemin tonë tatimor, i cili njihet për thjeshtësinë dhe funksionalitetin e tij, ne planifikojmë që njësimin e agjencive mbledhëse tatimore ta realizojmë në formë graduale. Pra, jemi duke punuar që këtë proces ta realizojmë duke filluar nga njësimi i njësive përkatëse të cilat kryejnë punë të ngjashme në njësi të vetme. Bashkimi i këtyre dy agjencive ka për qëllim ngritjen e efikasitetit të shërbimeve të këtyre dy institucioneve dhe gjithashtu të ulët ndjeshëm shkallën e ekonomisë joformale në vend.

Ekonomia: Zoti Ministër, kur do të jetësohen premtimet për eliminimin e pagesës së taksave në kufij nga ana e bizneseve (TVSH-së dhe doganës), edhe për lëndën e parë. A ka ndonjë datë dhe afat për finalizimin e tri ligjeve të pakos fiskale: Ligjit për TVSH, Ligjit për të Ardhurat e Korporatave dhe Ligjit për të Ardhurat Personale?

Hoti: Që nga fillimi i mandatit qeverisës, në Ministrinë e Financave kemi punuar intensivisht në legjislacionin në mënyrë që ta rregullojmë sistemin tatimor në vend. Faza e parë e punës ka qenë e koncentruar në ndryshimet në Ligjin për TVSH-në, Ligjin për të Ardhurat e Korporatave dhe Ligjin për të Ardhurat Personale. Këto ndryshime, të prezantuara mjaft detajisht në KASH, synim parësor kanë përkrahjen për prodhuesit vendorë, pra lirimet nga TVSH-ja për linjën e prodhimit dhe lëndën e parë. Gjithashtu, kemi vërejtur se ligjet në gjendjen siç kanë qenë kanë pasur mangësi të shumta në implementim dhe se Administrata Tatimore së bashku me bizneset kanë hasur në probleme të shumta dhe keqkuptime të ndryshme gjatë punës së tyre, fenomen i cili ka bartur në vete edhe kosto shtesë për bizneset dhe për Administratën Tatimore. Me këto ndryshime ne kemi harmonizuar ligjet mes vete dhe e kemi thjeshtuar në mënyrë që të implementohet sa më lehtë nga palët e involvuara. Pra, ndryshimet në këto ligje kanë përfunduar dhe këto ligje janë në procedura parlamentare për miratim dhe sipas planifikimit presim që të hyjnë në fuqi nga data 1 korrik e këtij viti.

Ekonomia: Çka parashohin këto tri ligje dhe sa do të ndikonin në reformat e paralajmëruara fiskale?

Hoti: Me këto ndryshime ne fillimisht kemi arritur që të largojmë barrierat e fiskalizimit, pra të liberalizojmë tregun për pajisjet fiskale. Së bashku me procesin e liberalizimit të tregut për pajisjet fiskale, kemi disenjuar masa shtesë për të stimuluar konsumatorët në mbledhjen e kuponëve fiskalë dhe ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e formalizimit të bizneseve.

Ndërsa, ndryshimi në ligjin mbi Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, si pjesa legjislative që reflekton reformën më të madhe fiskale në raport me legjislacionin tjetër rregullativ tatimor, përmban: uljen e pragut për regjistrim të TVSH-së nga 50.000 euro në 30.000 euro. Kjo reformë fiskale përmban edhe përshkallëzimin e TVSH-së. Pra kemi vendosur një normë të reduktuar për produktet bazë, në masë prej 8%, me qëllim të shpërndarjes më të barabartë të të ardhurave. Kemi marrë për bazë shkallën e lartë të papunësisë dhe faktin se shumica e popullsisë shpenzon rreth 45% të të ardhurave të tyre në produkte ushqimore dhe kemi vlerësuar se reduktimi i normës së TVSH-së në produkte themelore do të rrisë mirëqenien në vend, e në veçanti atë të qytetarëve me të ardhura më të ulëta.

Ndër hapat më sinjifikantë, që reflektohet në ligjin e TVSH-së dhe në reformën fiskale, përpos përshkallëzimit të TVSH-së, është lirimi nga TVSH-ja i linjave të prodhimit dhe makineritë që ndërlidhen me atë prodhim. Ndërsa faza e dytë e stimujve për prodhuesit vendorë konsiston me lirime nga obligimet doganore për aktivitetet prodhuese e cila do të jetë në funksion të nxitjes së prodhimit vendor dhe si rrjedhojë në zëvendësim të importit, kjo masë pritet të përmirësojë likuiditetin e bizneseve prodhuese vendore dhe është e një rëndësie të veçantë duke marrë parasysh vështirësitë dhe koston e lartë për ndërmarrjet në qasje në financa. Gjithashtu, presim që këto masa, në periudhën afatmesme, do të shërbejnë si një stimul shtesë në ngritje të investimeve private dhe rrjedhimisht prodhimit vendor dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Vendosmëri për krijimin e Fondit për Zhvillim

Ekonomia: Deri kur do të vazhdojnë të qëndrojnë mjetet e Kosovës jashtë vendit dhe a ka ndonjë ide dhe qëndrim të kësaj Qeverie, e përbërë nga jo pak ekonomistë të shquar që ato të kthehen në vend?

Hoti: Për sa u përket mjeteve nga fondi i privatizimit, ato mjete së pari duhet të lirohen nga të gjitha pretendimet eventuale nga palët e interesit dhe pas këtij procesi të shohim se sa prej këtyre mjeteve janë të lira për destinime të ndryshme zhvillimore. Tashmë kemi shprehur vendosmërinë tonë për krijimin e Fondit për Zhvillim, fond i cili do të jetë mbështetës për sektorin privat. Rrjedhimisht, pjesa nga mjetet e lira nga procesi i privatizimit do të shërbejë në krijimin e këtij fondi dhe gjithashtu synimi ynë është që ky fond të gjejë mbështetje financiare edhe nga partnerët tanë ndërkombëtarë dhe ky fond të shërbejë si mjet drejt zhbllokimit të potencialit tonë zhvillues ekonomik.

Ekonomia: A mendoni ju personalisht se në Kosovë ka mjaft siguri për të qenë të sigurta këto mjete, sikundër edhe për t'u zvogëluar akoma kamatat enorme të bankave komerciale të kreditimit të kosovarëve?

Hoti: Është e evidente se puna e vazhdueshme në reforma strukturore ka ndikuar në ngritjen e sigurisë së gjithmbarshme në vend. Njëherësh edhe puna e vazhdueshme në reforma strukturore do të ndikojë më tutje në krijimin e një ambienti sa më miqësor për biznese dhe rrjedhimisht për investime të reja. Megjithatë, konsiderojmë se niveli i sigurisë nuk ka qenë determinuesi kryesor i vendimit për investime të mjeteve financiare publike në vend. Si determinues kryesor i vendimeve për investime të fondeve publike, pra mjeteve jashtëbuxhetore, janë dispozitat ligjore në fuqi. Mirëpo, puna e vazhdueshme në reformat strukturore, në sektorin e rendit dhe ligjit, po jep sinjalet e para drejt normalizimit të kostos së financimit bankar. Të dhënat e fundit tregojnë se norma mesatare e interesit në kredi tashmë është në kuotën më të ulët që nga funksionimi i sektorit financiar dhe jemi të bindur se me fillimin e funksionimit të skemave mbështetëse qeveritare dhe nga partnerët ndërkombëtarë për bizneset, këtu kemi parasysh skemën për garantimin e kredive, norma mesatare e interesit në kredi do të shënojë rënie.

Ekonomia: A keni frikë nga rritja relativisht e madhe e borxhit publik në vitin e fundit dhe a ka potencë financiare Kosova që të obligohet me borxhe të mëdha të reja?

Hoti: Ne me secilin dokument strategjik në fuqi kemi shprehur përkushtimin tonë për stabilitet fiskal si parakusht për stabilitetin makroekonomik. Rrjedhimisht, ne kemi arritur të krijojmë mekanizma ligjorë që na sigurojnë mirëmbajtjen e financave publike, pra edhe të borxhit publik. Domethënë, secili planifikim fiskal dhe financiar i parasë publike është i ndërtuar mbi bazën e sigurimit të stabilitetit fiskal dhe prioriteteve strategjike zhvillimore. Fatmirësisht, ne ballafaqohemi me një nivel të borxhit publik mjaft të ulët dhe gjithashtu si rezultat i këtyre mekanizmave rregullativë, zhvillimet e borxhit publik janë në nivel tërësisht të menaxhueshëm.

Ekonomia: Keni përmendur së fundi se po punoni për krijimin e një Fondi Investues për Bizneset. A mund të na thoni se kur do të krijohet ky fond, cili do të jetë roli dhe prej nga do t'i siguroni paratë për të?

Hoti: Si politikë e re, jemi të përkushtuar që themelimit të Fondit për Zhvillim t'i sigurojmë një bazë të mirëfilltë legislative në mënyrë që ekzekutimi i këtij fondi të jetë mirë i targetuar dhe mirë i monitoruar. Tashmë kemi krijuar një grup punues i cili do t'i paraprijë këtij procesi dhe brenda këtij viti presim që të kemi një draftligj të cilin do ta diskutojmë edhe me palët e interesit. Me këtë ligj në synojmë të specifikojmë shumë qartë sektorët përfitues, mekanizmat e funksionimit si dhe modalitetet e financimit të tij.

Ekonomia: Cilat biznese do të përfitojnë nga Fondi?

Hoti: Në dokumentet e publikuara strategjike kemi shprehur drejtimin tonë për sektorët që do të kenë mbështetje të theksuar nga skemat e ndryshme qeveritare. Pra, në të gjitha incentivat e disenjuara nga kjo Qeveri jemi fokusuar në sektorët e prodhimit. Kjo me qëllim që investimet tona të jenë sa më efikase në ngritjen e aktivitetit të qëndrueshëm ekonomik nga i cili do të mundësohet edhe krijimi i vendeve të reja të punës.